



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" për aktivitetin: "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511 nxjerr:

VENDIM

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" e datës 19.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 15.11.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Anullohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.11.2019* dhe aktiviteti kthehet në rivleresim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Rahovica Comerc SHPK" me datë 19.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.11.2019 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi i ankuesit lidhur me deshmite e të rekomanduara për kontrate se ato nuk janë punime të asfaltit dhe punime adekuate të ndertimit të ulët, konsiderojmë se është i pa bazuar, pasi që kërkesa nga FDT-ja ka qenë se tenderuesi duhet të ofrojë deshmë se ka

perfunduar me sukses kontrata te ngjajshme(ndertim i ulet) dhe se deshmit e ofruara per kontratat per pune te ujesjellesit dhe rregullimit te lumenjeve i takojne ketij lloji te ndertimit;

- Pretendimi per shkeljen e nenit 69 lidhur me aftesite teknike dhe profesionale eshte i bazuar,pasi qe nga deshmit e ofruara vetetohet se deshmita per paisjen Makine sperkatese me emulsion deshmon se eshte ne pronesi te nje Operatori tjeter,respektivisht te OE-ik :“Eskavatori MK”,i cili vepron jashte Kosoves gje qe deshmohet edhe nga Deklarata Unike Doganore e dorezuar ne tender.
- Pretendimi lidhur me çmimin jonormalisht te ulet bazuar ne çmimin e paraqitur per pozicion eshte pjeserisht e bazuar,por kjo duhet te verifikohet ne procesin e rivleresimit se a eshte ne harmoni me Rregullat per tenderet jonormalisht te ulet.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se aktiviteti duhet te kthehet ne rivleresim dhe ne ate proces kerkoj qe te behet nje vleresim i sakte i te gjitha deshmitave te ofruara nga tenderuesit e posaçerisht saktesia dhe validiteti i paisjeve per pune dhe i çmimeve te cilat mund te jene te trajtuara sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit